

VENDIM
Nr.131, datë 24.12.2014

**PËRRINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45, pika 3, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; nenit 16 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2014, pasishqyrtoi aplikimin e shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pikat 1,2 dhe 3) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës shoqërisë “AXPO Albania” sh.a., për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 21.12.2009 për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti